



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 10, datë 28.01.2010

PËR

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 115, DATË 10.12.2009 “MBI KRIJIMIN E FONDIT TË KOMPENSIMIT PËR VITIN 2010”

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006, “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, nenit 45, paragrafi 4, të Ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, me propozim të Departamentit të Licencim Monitorimit, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E:

Në bazë të ligjit nr. 10 076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, neni 45, “shoqëritë e sigurimit, të cilat ushtrojnë veprimtari në territorin e R.SH në sigurimin e detyrueshëm motorik, janë të detyruara të kontribuojnë çdo vit financiarisht në fondin e kompensimit, në përpjestim të drejtë, me primet bruto të shkruara në këto lloj sigurimesh, në vitin paraardhës. Autoriteti, me propozim të Byrosë, vendos çdo vit shumën e kontributeve, sipas pikave 2 e 3 shkronja b, dhe afatin brenda të cilit duhet të bëhet derdhja.

Byroja me shkresën nr. 190 prot., datë 3.2.2010, ka kërkuar një ndryshim lidhur me zbatimin e Vendimit të Bordit të Autoritetit nr. 115, datë 10.12.2009 “Mbi krijimin e Fondit të Kompensimit për vitin 2010”.

Byroja propozon që masa e kontributit të shoqërive të sigurimit në Fondin e Kompensimit të përcaktohet pas hartimit të metodologjisë së përlllogaritjes së Fondit të Kompensimit dhe kontributi për tremujorin e parë të vitit 2010, të ruajë nivelin e masës së kontributit të vitit të kaluar prej 5%, si paradhënie e kontributit.

Pas hartimit dhe miratimit të rregullores së metodologjisë së përlllogaritjes së Fondit të Kompensimit për vitin 2010, Byroja do të rillogarisë dhe do të propozojë kontributin e Shoqërive të Sigurimit për vitin 2010.

Për sa më sipër Autoriteti,

V E N D O S I:

1. Ndryshimin e pikës 2 të Vendimit të Bordit të Autoritetit nr. 115, datë 10.12.2009 “Mbi krijimin e Fondit të Kompensimit për vitin 2010”, si më poshtë:
“Për tremujorin e parë të vitit 2010, të ruhet niveli i masës së kontributit të vitit të kaluar prej 5%, si paradhënie e kontributit vjetor 2010. Ky kontribut duhet të derdhet brenda datës 12 shkurt 2010.”

2. Masa e kontributit të shoqërive të sigurimit në Fondin e Kompensimit për vitin 2010, të përcaktohet sipas metodologjisë së përlllogaritjes së Fondit të Kompensimit, dhe t'i propozohet Autoritetit për miratim.
3. Ngarkohet Byroja dhe departamentet përkatës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Elisabeta GJONI